



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:278979
Datë: 30.08.2022
Numri i dokumentit: 03564016

C.nr.1144/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të paditësit S. K. nga fshati Xerxe Komuna Rahovec, B. E. nga fshati Brestoc Komuna Rahovec dhe Xh. E. nga fshati Brestoc Komuna Rahovec, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati D. M. nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor M. Sh., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit **2,507.00 €**, pas mbajtjes përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, më **17.08.2022**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpafia e paditëseve: S. K., B. E. dhe Xh. E. në tersi si e bazuar dhe

OBLIGOHET e paditura Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që:

Paditësit **S. K.** për periudhën kohore, 17.04.2017 deri 30.12.2020, t’ia paguajë në emër të **Shpenzimeve për udhëtim** për 456 dite punë për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacione në shumë prej 5 euro të i paguaj shumen prej **1,596.00 Euro** ($70\% \text{ i } 5,00 \text{ euro} = 3,5 \text{ euro} \times 456 \text{ ditë pune} = 1,596,00 \text{ euro}$), me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padis dt.15.01.2022 e deri në pagesën definitive e brenda afatit prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim.

Paditësit **B. E.** për periudhën kohore, 17.04.2017 deri 30.12.2020, t’ia paguajë në emër të kompensimit për shpenzime të udhëtimit për **455** dite punë për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacione në shumë prej 1,40 € të i paguaj shumen prej **445.9 Euro** ($70\% \text{ i } 1,40 \text{ euro} = 0,98 \text{ euro} \times 455 \text{ ditë pune} = 445,9,00 \text{ euro}$), të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padis dt. 15.01.2022 e deri në pagesën definitive e brenda afatit prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim përmbarrim.

Paditësit **Xh. E.**, për periudhën kohore, 01.01.2020 deri 17.04.2021, t’ia paguajë në emër të kompensimit për shpenzime të udhëtimit për **456** dite punë për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacione në shumë prej 1,40 € të i paguaj

shumen prej **446.9 Euro** ($70\% \text{ i } 1,40 \text{ euro} = 0,98 \text{ euro} \times 456 \text{ ditë pune} = 446,9,00 \text{ euro}$), të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padis dt. 15.01.2022 e deri në pagesën definitive e brenda afatit prej 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim

DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej **707.00 €** me kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit S. K., B. E. dhe Xh. E., nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit.

Sipas kësaj çështje juridike është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor, në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i paditësve avokati D. M., si dhe përfaqësuesi i të paditurës M. Sh..

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve avokati D. M. ka deklaruar: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, pranë propozimit që në shqyrtimit gjyqësor të shqyrtohen provat materiale me të cilat do të vërtetohet se baza juridike e padisë është e pa kontestueshme për faktin se kontrata kolektive e Arsimit të Kosovës ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, e deri me datën 17.04.2021, kur në faqen zyrtare të Republikës së Kosovës, në lidhje me vijueshmërinë në punë gjegjësisht ditët e prezencës në punë vërtetohet përmes vërtetimit të lëshuara nga shkolla dhe vërtetimin e marre nga DKA, sa i përket legjitimitetit të paditësve në kërkesa vërtetohet përmes kontratës së punës të lidhura në mes paditësit dhe të paditurës lartësia e kërkesëpadisë bazuar në ditët e punës dhe nenit 35 të kontratës kolektive ku ka përcaktuar shumën e kompensimit, ndërsa lartësia e kërkesëpadisë u vërtetua përmes administrimit të vërtetimit të lëshuara nga institucioni shkollor dhe DKA me të cilat vërtetohet vijueshmëria për prezencë në punë dhe faktin se te njëjtit kanë udhëtuar ne relacionet vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga SHT, andaj konsideron se u vërtetua në tërësi baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë, e mbi këtë i propozoi gjykatës që padinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar, shpenzimet të procedurës i kërkuan dhe atë: për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21,00 Euro, për përpilimin e padisë në shumë prej 208,00 Euro, për përfaqësim në seanca shumën prej 270.00 Euro, për përpilimin e zgjerimit të padisë shumën prej 208,00 Euro.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës B. O. ka deklaruar se në tërësi e kontestojnë kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të pathemeltë ndaj të paditurës komuna e Rahovecit me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv duke marrë për bazë se kontrata kolektive është nënshkruar nga organi i nivelit qendror nga MASHT dhe SBASHK ndërsa e paditura nuk ka qenë nënshkruar e kësaj kontrate si nivel lokal kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 2 i Ligjit të Punës me të cilin është paraparë që kontrata kolektive mund të lidhet në tri nivele. E paditura mendon që paditësit duke marrë për atë theksimet si më lart është dashur që kërkesëpadinë ta drejtoj edhe ndaj Ministrisë së Arsimit si nënshkruar të kontratës në fjalë. E paditura në parim nuk ka kundërshtuar dispozitat e Kontratës Kolektive të cilat kanë qëllim përmirësimin e kushteve për mësimdhënësit por që në bazë të dispozitave që kanë implikime financiare nuk ka mundësi buxhetore dhe për të zbatuar këto dispozita pasi që palët kontraktuese në këtë kontratë nuk kanë zbatuar nenin 46 të së njëjtës. Mbrojtja e të paditurës mbetet në qëndrimin si në përgjigje në padi, ngase kontrata kolektive është nënshkruar në mes të MASHT

dhe SBASHK dhe ashtu siç konstaton edhe Gjykata Kushtetuese në rastin numër KO139/18 se kjo kontratë reflekton vullnetin reciprok në mes të dy palëve nënshkruese. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Punës respektivisht me asnjë dispozitë të këtij ligji nuk është paraparë e drejta e punëtorit të pensionuar apo në marrëdhënie pune në realizimin e të drejtës për pagesën e pagës përcjellëse, shpërblimit jubilar apo shpenzimeve të rrugës, të ushqimit si në kërkesëpadinë e paditësve, konsiderojnë se paditësit nuk kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë administrative për të realizuar interesin e tyre juridik në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të ligjit numër 06/L-114 për zyrtarët publik. Sa i përket buxhetimit të mjeteve lidhur me kërkesëpadinë e paditësve e paditura në përgjigje në padi ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e alokimit të buxhetit për nivelin lokal siç është e paditura këtu, theksojmë se në bazë të qarkoreve buxhetore të Ministrisë së Financave për vitin 2019, 2020 dhe 2021 në asnjë nga këto qarkore të cilat konsiderohen dokumente bazë për krijimin e buxhetit vjetor, nuk është paraparë respektivisht nuk është alokuar asnjë mjet financiar për kompensimin e ushqimit apo të udhëtimit. Për vitin 2019 komunës së Rahovecit i janë alokuar mjetet në shumën prej 22.967,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse, kjo në bazë të kalkulatorit sipas pikës 2.2 të kësaj qarkore. Në vitin 2020 komunës së Rahovecit i janë alokuar 46.643,00 Euro në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit, ndërsa për vitin 2021 në emër të tri pagave përcjellëse të pensionimit janë ndarë gjithsej 42.150,00 Euro dhe për herë të parë janë ndarë 27.169,00 Euro në emër të pagave jubilar sipas kontratës kolektive andaj përtej kësaj që është paraparë në Ligjin për Buxhetin e RKS-së dhe ndarjes buxhetore, e paditura nuk ka kompetencë ligjore për të kryer pagesat tjera në emër të kompensimeve sipas kontratës kolektive të arsimit para universitar. Rrjedhimisht për të gjitha vitet sipas kërkesës për kompensimin e ushqimit dhe udhëtimit janë përtej mundësive ligjore për të kryer pagesa sipas kërkesëpadisë së paditësve. Në aspekt procedural gjykata nuk ka vepruar në përputhje me nenin 67 dhe 68 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i propozojmë gjykatës që kësaj lënde të ia bashkojë edhe lëndë të tjera me paditës me bazë të njëjtë të padisë në emër të parimit të ekonomizimit të procedurës. E paditura, përveç kësaj thekson se kërkesëpadia në aspekt kohor nuk ka bazë ligjore për arsye se KKAK, ka qenë në fuqi nga data 18.04.2017 deri më 18.04.2020, kjo në kuptim të nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Punës me të cilin është përcaktuar se kontrata kolektive mund të lidhjet në një afat të caktuar kohor por jo më shumë se tri vite. Kontrata e Re ka përcaktuar rregulla tjera për pagesat e kompensimeve, e sipas të njëjtës nuk mund të kërkohet kompensim para vitit 2023, sepse për këtë periudhë i është dhënë mundësia palëve kontraktuese që ti kryejnë obligimet deri në fund të vitit 2023, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësve përtej datës 17.04.2020 është e pabazuar. Lidhur me objektin e shqyrtimit lëndor i propozojmë gjykatës që ti bashkoj subjektet paditëse në grupe sipas shkollave ngase me këtë hyjnë në zbatim parimi i ekonomizimit të procedurës si në sqarim në përgjigje në padi.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar provat duke bërë shikimin e tyre, ka bërë shikimin e kërkesës drejtuar DKA-së, për paditësin S. K. ka bërë shikimin në kontratat e punës me nr. 198 dt. 22.09.2015, ka bërë shikimin në certifikatën e vendbanimit, vërtetimin e lëshuar nga SHATP ne Prizren, Për paditësin B. E. ka bërë shikimin në kontratat e punës me nr. 250 dt. 08.10.2015, ka bërë shikimin në vërtetimin për ditët e punës nr. 185/2021 dt.22.02.2021, vërtetimin e lëshuar nga SHATP ne Prizren, për paditësin Xh. E. ka bërë shikimin në kontratat e punës me nr. 204 dt. 22.09.2015, ka bërë shikimin në vërtetimin për ditët e punës nr. 185/2021 dt.22.02.2021, vërtetimin e lëshuar nga SHATP ne Prizren.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërjyqësve dhe në bazë

të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, për paditësin S. K. ka proceduar kontratën e punës me nr. të protokollit 198 të datës 22.09.2015, dhe se gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si profesor SHML “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr.151/2021 të datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësi po ashtu është i sistemuar ne pune dhe detyrat e punës ne SHML “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, dhe vërtetohen ditët e prezencës ne pune.

Me shikimin në certifikatën e vendbanimit është vërtetuar fakti se paditësi vendbanimin e ka ne fshatin Xërxë dhe i njëjti punon ne Rahovec.

Me shikimin e vërtetimit te lëshuar nga Shoqata e Transportit, gjykata ka vërtetuar se çmimi i biletës se udhëtimit është ne vlere prej 5.00 euro për dy relacione.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, për paditësin B. E. ka proceduar kontratën e punës me nr. të protokollit 250 të datës 08.10.2015, dhe se gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si profesor SHML “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr.134/2021 të datës 16.02.2021 vërtetohet se paditësi po ashtu është i sistemuar ne pune dhe detyrat e punës ne SHML “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, dhe vërtetohen ditët e prezencës ne pune.

Me shikimin në Kopjen e letërnjoftimit është vërtetuar fakti se paditësi vendbanimin e ka ne fshatin Brestoc dhe i njëjti punon ne Rahovec.

Me shikimin e vërtetimit te lëshuar nga Shoqata e Transportit, gjykata ka vërtetuar se çmimi i biletës se udhëtimit është ne vlere prej 1.40 euro për dy relacione.

Gjatë procedurës së provave, kjo gjykatë si provë të veçantë, për paditësin Xh. E. ka proceduar kontratën e punës me nr. të protokollit 204 të datës 22.09.2015, dhe se gjykata pa kusht ka vërtetuar faktin relevant se këtu paditësi ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës si profesor SHML “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec.

Me shikimin në vërtetimin mbi përvojën e punës si dhe mbi ditët e prezencës në punë me nr.185/2021 të datës 22.02.2021 vërtetohet se paditësi po ashtu është i sistemuar ne pune dhe detyrat e punës ne SHML “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, dhe vërtetohen ditët e prezencës ne pune.

Me shikimin në Kopjen e letërnjoftimit është vërtetuar fakti se paditësi vendbanimin e ka ne fshatin Brestoc dhe i njëjti punon ne Rahovec.

Me shikimin e vërtetimit te lëshuar nga Shoqata e Transportit, gjykata ka vërtetuar se çmimi i biletës se udhëtimit është ne vlere prej 1.40 euro për dy relacione.

Sipas dispozitës së nenit 35.5 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: **“Punonjësit arsimore qe udhëtojnë ne vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% te biletës se trafikut urban”**.

Gjykata shqyrtoj edhe prapësimin e palë së paditur dhe gjeti si te pa bazuar se prej datë 18.04.2020 nuk ka afat Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, por gjeti se referuar Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 përkatësisht nenit 45, është paraparë se: **“Nëse nga Kontrata Kolektive pasi ti skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”**.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësve në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësve t’ia paguajë pagat në emër të udhëtimit dhe ushqimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjes faktike me prova materiale bindëse, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t’ia kompensoj paditësve shumën prej 707.00 €, e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 208,00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 21,00 €, si dhe për përfaqësim në seancë shumën prej 270.00 €, për përpilimin e zgjerimin e padisë shumën prej 208,00 €,

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.1144/2021 dt.17.08.2022

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.